VENDIM
Nr. 546, datë 27.7.2016

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E STACIONIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE TË BASHKISË POGRADEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, të sipërfaqes prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m^2, me vendndodhje sipas të dhënave në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Bashkisë Pogradec.
2. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Qarkun e Korçës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga tokë bujqësore (arë) në tokë truall, për sipërfaqen prej 5 900 (pesë mijë e nëntëqind) m2, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Korçë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

TOKË BUJQËSORE (KATEGORIA VIII)

Bashkia	**Njësia administrative**	**Fshati**	**Zona kadastrale**	**Numri i pasurisë**	**Pronari**	**Lloji i pasurisë**	**Kategoria e tokës bujqësore**	**Truall i kërkuar (m^2)**
Pogradec	Çërravë	Çërravë	1387	77	tokë shtet	arë	VIII-të	5900